



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE BASHKIA SARANDË

2025-2030



Fjala e Kryetarit të Bashkisë Sarandë

Të nderuar qytetarë, partnere dhe miq,

Me kënaqësi paraqes Planin e parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të Bashkisë Sarandë për periudhën 2025–2030. Ky dokument është më shumë se një plan pune, ai përfaqëson angazhimin tonë të përbashkët për të ndërtuar një komunitet më të drejtë, më gjithëpërfshirës dhe më të barabartë për çdo qytetare dhe qytetar.

Barazia gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor dhe moral, por një parakusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm. Një Sarandë që ofron mundësi të barabarta për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, është një qytet më i fortë, më konkurrues dhe më solidar. Përmes këtij plani, ne synojmë të integrojmë perspektivën gjinore në çdo fushë të jetës vendore: nga vendimmarrja dhe ekonomia, tek arsimi, shëndeti, kultura, mjedisi dhe turizmi.

Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, ku janë bashkuar përpjekjet e administratës vendore, Këshillit Bashkiak, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit, të rinjve, grave dhe burrave të Sarandës. Kontributi i tyre ka qenë i pazëvendësueshëm për të hartuar një plan realist, të bazuar në nevojat e komunitetit dhe të mbështetur mbi praktika të mira.

Si Kryetar i Bashkisë Sarandë, unë garantoj angazhimin tim të plotë dhe të gjithë strukturave bashkiake për zbatimin e këtij plani. Barazia gjinore nuk është një çështje vetëm e grave, por një vlerë që prek çdo familje dhe e ardhmja e çdo qyteti. Ne jemi të vendosur të krijojmë politika, shërbime dhe mundësi që reflektojnë këtë bindje.

Ftoj të gjithë partnerët, qeverinë qendrore, organizatat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, sektorin privat dhe mbi të gjitha qytetarët e Sarandës të bëhen pjesë e zbatimit të këtij plani. Vetëm së bashku mund të arrijmë një Sarandë ku respekti, dinjiteti dhe barazia janë vlera të prekshme në jetën e përditshme të secilit prej nesh.

Me respekt,

OLTION ÇAÇI

KRYETAR I BASHKISË SARANDË

Lista e shkurtimeve

Akronimi	Emërtimi i plotë
AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
KBGJ	Komisioni për Barazinë Gjinore
KV	Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje
LGBTI+	Persona lezbike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe persona të tjerë me orientim seksual dhe/ose shprehje të identitetit gjinor të ndryshëm nga ai heteroseksual
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OS	Objektiv Specifik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021–2030)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

I. HYRJJE

Barazia gjinore është një nga parakushtet thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm, për forcimin e demokracisë vendore dhe për garantimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie. Për Bashkinë Sarandë, nxitja e barazisë gjinore nuk përbën vetëm një detyrim ligjor dhe moral, por edhe një mundësi për të përmirësuar cilësinë e qeverisjes, për të rritur kohezionin social dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, ky dokument përbën Planin e Parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të hartuar në nivel bashkie. Ai shënon një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, duke krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm planifikimi dhe monitorimi.

Plani është ndërtuar mbi kontekstin specifik të Sarandës, një bashki bregdetare me potencial të lartë turistik dhe zhvillimor, por edhe me sfida të veçanta. Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, popullsia banuese e Bashkisë Sarandë është 22,613 banorë (11,393 meshkuj dhe 11,220 femra), ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile (korrik 2025) popullsia e regjistruar arrin në 57,452 banorë dhe 20,731 familje, duke reflektuar ndikimin e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm. Organizimi administrativ përfshin Njësinë Qendrore Sarandë me 19,882 banorë dhe Njësinë Administrative Ksamil me 2,731 banorë. Struktura demografike tregon një përqindje të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç (4,603 banorë) krahasuar me grupmoshën 0–14 vjeç (3,565 banorë), çka sinjalizon nevojën për shërbime të zgjeruara për të moshuarit.

Punësimi sezonal, pabarazitë në paga dhe përfaqësimi ende i kufizuar i grave në nivelet e larta të vendimmarrjes mbeten sfida të dukshme. Analizat e Planit Social 2026–2029 tregojnë se disa grupe janë veçanërisht të cenuara, përfshirë gratë kryefamiljare, gratë dhe vajzat në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë e papunë dhe të moshuarit, ku gratë shpesh përballen me barriera të shumëfishta për akses në arsim, punësim dhe shërbime sociale.

Bashkia Sarandë ka ndërmarrë hapa konkretë për adresimin e çështjeve gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, përmes funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për rastet e

dhunës në familje, ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetjes për viktimat e dhunës. Në vitet e fundit janë trajtuar dhjetëra raste çdo vit (26 raste në 2022, 19 raste në 2023 dhe 23 raste deri në fund të 2024), duke ofruar ndihmë ekonomike, strehim emergjent, këshillim psikologjik, ndihmë juridike dhe mbështetje për punësim.

Qëllimi i PVVBGJ 2025–2030 është krijimi i një qasjeje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të matshme për promovimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës vendore – përfshirë ekonominë, shëndetin, arsimin, kulturën, mjedisin, turizmin dhe qeverisjen vendore – si dhe garantimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrje, zhvillim dhe përfitim nga politikat dhe programet bashkiake për të gjitha gratë dhe burrat në Sarandë.

Plani vendos objektiva strategjike dhe masa konkrete për një periudhë 6-vjeçare, të mbështetura mbi parimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe mbi angazhimin e të gjitha strukturave bashkiake, në bashkëpunim me institucionet publike, shoqërinë civile, komunitetin dhe sektorin privat. Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore janë të lira të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta apo paragjykimet. Ajo nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të jenë të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk varen nga gjinia.

Drejtësia gjinore kërkon që gratë dhe burrat të trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse, shpesh përmes masave që kompensojnë disavantazhet historike dhe sociale. Sikurse theksohet në Kartën Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si niveli më afër qytetarëve, kanë potencialin të luftojnë pabarazitë dhe të nxisin një shoqëri të barabartë duke bashkëpunuar me gjithë aktorët vendorë.

PVVBGJ 2025–2030 është konceptuar në përputhje me nenet e Kartës Evropiane për Barazi, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave, në gjithë diversitetin e tyre, mbetet një ndër synimet kryesore për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore në Bashkinë Sarandë. Të gjitha masat dhe veprimet janë të shoqëruara me tregues rezultatash, drejtoritë përgjegjëse, institucionet dhe organizatat partnere, afatet kohore, mekanizmat e monitorimit dhe kostot përkatëse, duke u lidhur ngushtë me fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe rezultatet e pritshme.

Pavarësisht harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, realiteti tregon se barazia dhe drejtësia gjinore ende mungojnë plotësisht në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi, shpesh të mbështetur në stereotipe të rrënjosura në familje, arsim, kulturë, komunikim, tregun e punës dhe organizimin shoqëror, vijojnë të jenë prezentë. Prandaj, integrimi i perspektivës gjinore në politikat, organizimin dhe praktikat e punës të bashkive është thelbësor për ndërtimin e një shoqërie të bazuar në barazi. Barazia e vërtetë gjinore është gjithashtu çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror të Sarandës.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Hartimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 të Bashkisë Sarandë mbështetet në parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), i cili ndalon çdo formë diskriminimi për shkaqe që lidhen me gjininë, racën, fenë, bindjet politike, gjendjen ekonomike, sociale ose arsimore. Ky parim është i lidhur ngushtë me detyrimet që Shqipëria ka marrë përmes ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare, të cilat zënë vend pas Kushtetutës në hierarkinë ligjore dhe kanë fuqi detyruese për të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë edhe atë vendore.

Instrumentet ndërkombëtare kryesore mbi të cilat mbështetet ky plan përfshijnë:

- Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, si akt angazhimi praktik për integrimin e perspektivës gjinore në politikat vendore.
- Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993.
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), në fuqi në Shqipëri që nga viti 2013.
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjendën 2030, veçanërisht Objektivin 5 për barazinë gjinore.
- Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III).

Kuadri ligjor kombëtar që udhëheq këtë plan përfshin, ndër të tjera:

- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (në proces rishikimi).
- Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.

Politikat kombëtare të referuara:

Ky plan harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e cila përcakton objektivat strategjike në fushat e fuqizimit ekonomik të grave, përfaqësimit dhe vendimmarrjes, eliminimit të dhunës me bazë gjinore dhe forcimit të mekanizmave institucionale për barazinë gjinore.

Institucionet përgjegjëse dhe struktura vendore në Sarandë

Zbatimi i barazisë gjinore në nivel vendor kërkon një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve vendore, organeve vendimmarrëse dhe aktorëve të shoqërisë civile, në përputhje me detyrimet ligjore kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Kjo qasje siguron që parimet e barazisë gjinore të përkthehen në politika konkrete dhe masa të matchme që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.

Në nivel vendor, zbatimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore do të koordinohet nga Bashkia Sarandë, përmes Nëpunësit për Barazinë Gjinore¹/Koordinatorit Vendor kundër dhunës në familje, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse dhe njësitë administrative. Ky bashkëpunim siguron integritetin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe shërbimet vendore.

Një rol të veçantë në këtë proces do të luajnë Komisioni për barazinë gjinore dhe çështjet sociale në Këshillin Bashkiak, të cilët garantojnë mbikëqyrjen dhe përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore në proceset e vendimmarrjes.

Për të forcuar mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit, Bashkia Sarandë do të krijojë Komisionin për Barazi Gjinore / Grupin Monitorues², i cili do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha drejtorive përgjegjëse dhe partnerë nga organizatat e shoqërisë civile. Ky strukturim do të mundësojë përfshirjen e qëndrueshme dhe sistematike të perspektivës gjinore në të gjitha dokumentet zhvillimore të bashkisë, duke synuar rezultate të matshme dhe të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së grave dhe vajzave në territorin e saj

III. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Plani Vendor për Barazinë Gjinore hartohet për herë të parë nga Bashkia Sarandë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të integritetit të perspektivës gjinore në politikat, programet dhe shërbimet vendore. Analiza e situatës është ndërtuar mbi të dhënat e Planit Social 2026–2029, statistikave vendore dhe kombëtare, si dhe informacionin e mbledhur nga Koordinatori Vendor për Dhunën në Familje, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit dhe partnerët e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë.

¹ Roli i Nëpunësit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Sarandë aktualisht mbulohet nga **Koordinatori vendor kundër dhunës në familje**. Sipas kuadrit ligjor shqiptar për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, bashkitë duhet të caktojnë një nëpunës përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore. Në mungesë të një pozicioni të dedikuar, ky rol shpesh i delegohet Koordinatorit kundër dhunës në familje.

² Komisioni për Barazi Gjinore / Grupi Monitorues do të ketë rol këshillimor dhe mbikëqyrës, duke monitoruar zbatimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore, vlerësuar progresin, identifikuar boshllëqet dhe propozuar masa korrigjuese. Përbërja e tij mund të përfshijë përfaqësues nga: këshilli bashkiak, administrata vendore (nëpunësi i barazisë gjinore / koordinatori kundër dhunës në familje), njësitë administrative, si dhe organizata të shoqërisë civile me veprimtari në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna. Ky përbërje siguron gjithëpërfshirje, transparencë dhe llogaridhënie në procesin e monitorimit.

Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, popullsia rezidente e Bashkisë Sarandë arrin në 22,613 banorë (11,393 meshkuj dhe 11,220 femra), duke treguar një raport pothuajse të barabartë gjinor. Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile (korrik 2025), popullsia e regjistruar është 57,452 banorë dhe 20,731 familje, çka reflekton një shkallë të lartë të migracionit të brendshëm dhe të jashtëm, sidomos drejt qyteteve të mëdha dhe jashtë vendit. Bashkia përbëhet nga Njësia Qendrore Sarandë me 19,882 banorë dhe Njësia Administrative Ksamil me 2,731 banorë. Struktura demografike tregon një peshë të konsiderueshme të popullsisë mbi 65 vjeç (4,603 banorë) krahasuar me grupmoshën 0–14 vjeç (3,565 banorë), çka sinjalizon nevojën për politika të posaçme për përkujdesjen e të moshuarve dhe për mbështetjen e familjeve me fëmijë.

Migracioni, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, prek kryesisht të rinjtë dhe familjet në moshë pune, duke krijuar boshllëqe të theksuara në komunitete, sidomos në zonat rurale. Një pjesë e grave mbeten kryefamiljare, të ngarkuara me përgjegjësi të mëdha ekonomike dhe kujdesi, shpesh pa mbështetje të mjaftueshme strukturore. Ekonomia vendore dominohet nga turizmi dhe sektori i shërbimeve, me punësim të lartë sezonal. Gratë janë të përqendruara kryesisht në pozicione me paga të ulëta, kontrata afatshkurtra dhe pak mundësi avancimi. Punësimi sezonal gjeneron të ardhura të përkohshme, por nuk ofron siguri financiare afatgjatë. Diferencat gjinore në paga mbeten të dukshme dhe sipërmarrja femërore është ende e kufizuar, pavarësisht potencialit për zhvillim të bizneseve të vogla e të mesme të drejtuara nga gra.

Përfaqësimi i grave në Këshillin Bashkiak dhe në pozitat drejtuese të administratës vendore është poshtë niveleve të kuotave të rekomanduara. Pjesëmarrja e grave në organizata komunitare dhe forume konsultimi është e ulët, veçanërisht në zonat rurale, duke treguar se pjesëmarrja qytetare nuk është ende e barabartë. Kjo kërkon ndërhyrje për fuqizimin e zërit të grave dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për angazhim publik. Dhuna me bazë gjinore mbetet një problem i pranishëm dhe shpesh i nënraportuar. Të dhënat nga Koordinatori Vendor për Dhunën në Familje tregojnë se gjatë viteve të fundit janë evidentuar dhjetëra raste çdo vit (26 raste në 2022, 19 raste në 2023 dhe 23 raste deri në fund të 2024), por numri real pritët të jetë më i lartë për shkak të hezitimit të viktimave për të kërkuar ndihmë. Aktualisht, në territorin e Bashkisë Sarandë funksionon një qendër emergjence 72-orëshe për viktimat e dhunës, e ngritur që prej vitit 2016. Përtej kësaj periudhe të menjëhershme, rastet e referuara trajtohen më tej në bashki të tjera ose pranë

organizatave partnere. Megjithëse Mekanizmi i Koordinuar i Referimit funksionon, nevojiten burime shtesë, staf i specializuar dhe trajnime të vazhdueshme për të forcuar efektivitetin e tij.

Shërbimet sociale për grupet në nevojë janë të pranishme, por kapacitetet e tyre janë të kufizuara dhe shpërndarja gjeografike nuk është e barabartë. Gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe të rinjtë e papunë përballen me pengesa të shumta në aksesin në arsim, punësim dhe mbështetje sociale. Në këtë kontekst, Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 synon të adresojë pabarazitë ekzistuese dhe të krijojë një model të qëndrueshëm të integritetit të perspektivës gjinore në zhvillimin e përgjithshëm të Bashkisë Sarandë, duke e vendosur barazinë gjinore si një shtyllë themelore të qeverisjes vendore dhe duke u fokusuar në masa konkrete për fuqizimin e grave, rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe përmirësimin e aksesit në shërbime e mundësi të barabarta për të gjithë.

IV. METODOLOGJIA

Plani Vendor për Barazinë Gjinore i Bashkisë Sarandë 2025–2030 është hartuar nga Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri” dhe PIK Green, në kuadër të programit RELOAD, me mbështetjen institucionale dhe financiare të Bashkisë Sarandë. Procesi i hartimit ka ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe të bazuar në evidencë, duke respektuar standardet e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 si dhe parimet e Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Në fazën e parë u krye mbledhja e të dhënave dhe analizimi i gjendjes aktuale. Për këtë qëllim u përdorën burime të ndryshme vendore dhe kombëtare, ndër të cilat Plani Social i Bashkisë Sarandë 2026–2029, statistikatat e INSTAT si dhe raporte nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë. Analiza e këtyre burimeve evidentoi si prirjet kryesore zhvillimore, ashtu edhe boshllëqet në informacion, veçanërisht nevojën për të dhëna të disagreguara sipas gjinisë, moshës dhe statusit socio-ekonomik.

Më tej, procesi u pasurua përmes konsultimeve të gjera me palët e interesit. Janë organizuar tryeza të rrumbullakëta, intervista gjysmë të strukturuar dhe fokus-grupe, të cilat mundësuan përfshirjen e një game të gjerë aktorësh: drejtori të Bashkisë, anëtarë të Këshillit Bashkiak, organizata të

shoqërisë civile, sektorin privat, përfaqësues të komuniteteve rurale, si dhe grupe vulnerabël, ndër të cilat gra të papuna, të rinj dhe persona me aftësi të kufizuara. Ky proces siguroi që perspektiva e çdo grupi të reflektohej në dokumentin përfundimtar.

Në vijim u krye një analizë gjinore sektoriale, e cila identifikoi pabarazitë ekzistuese dhe mundësitë për ndërhyrje në fusha si punësimi, pjesëmarrja politike dhe vendimmarrëse, arsimi, shëndetësia, kultura dhe sporti, mjedisi dhe siguria. Ky dimension analizash lejoi që objektivat strategjikë të përcaktoheshin jo vetëm mbi bazën e nevojave të përgjithshme të bashkisë, por edhe mbi problematikat e veçanta që përjetojnë gratë dhe burrat në situata të ndryshme sociale dhe ekonomike.

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe rekomandime, u hartua drafti i parë i Planit Vendor për Barazinë Gjinore. Drafti u ndërtua në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar përfshirë Ligjin për Barazinë Gjinore, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për të Drejtat e Fëmijës si dhe me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, ndër të cilat Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Agjenda 2030 e OKB-së dhe Konventa e Stambollit.

Në fazën përfundimtare, drafti u rishikua dhe u vu në konsultim me aktorët kryesorë lokalë dhe strukturat përkatëse të Bashkisë Sarandë. Komentet dhe sugjerimet e tyre u integruan në dokument, duke siguruar kështu një plan që pasqyron realitetin lokal, është i mbështetur mbi evidenca të besueshme dhe adreson nevojat e të gjitha grupeve të popullsisë, me theks të veçantë tek gratë dhe vajzat në situata të cënueshme. Ky proces i hapur dhe gjithëpërfshirës jo vetëm ka rritur legjitimitetin e planit, por ka nxitur edhe angazhimin e aktorëve lokalë për zbatimin e tij në mënyrë të qëndrueshme.

IV. VIZIONI, PARIMET UDHËHEQËSE, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

VIZIONI

Bashkia Sarandë aspirojnë një realitet ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë pavarësisht moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike, gjendjes sociale dhe ekonomike, aftësive të kufizuara apo nevojave të veçanta, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantit/azilkërkuesit, përkatësisë fetare apo karakteristikave të tjera individuale gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore në mënyrë të barabartë. Kjo vizionon një komunitet ku respekti, dinjiteti dhe barazia gjinore nuk mbeten vetëm parime në dokumente, por bëhen praktika të përditshme në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ekonomike, kulturore, politike dhe mjedisore duke e bërë Sarandën një shembull të zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

PARIMET UDHËHEQËSE

Vizioni i Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 për Bashkinë Sarandë mbështetet mbi një qasje strategjike që e konsideron barazinë gjinore si një përbërës të pandashëm të zhvillimit të qëndrueshëm, mirëqenies shoqërore dhe forcimit të demokracisë vendore. Ky vizion synon të garantojë që çdo qytetar dhe qytetare pavarësisht gjinisë, moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike e sociale, aftësisë së kufizuar apo karakteristikave të tjera individuale të gëzojë të njëjtat të drejta dhe mundësi për të marrë pjesë, kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi i komunitetit. Për ta bërë këtë të mundur, Plani mbështetet në një grup parimesh udhëheqëse të hartuara në përputhje me Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të cilat sigurojnë koherencë, gjithëpërfshirje dhe transparencë gjatë gjithë procesit të zbatimit.

Në themel të këtij kuadri qëndron barazia gjinore si e drejtë themelore, e cila garanton mundësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, duke eliminuar çdo formë diskriminimi dhe duke adresuar pengesat strukturore që kufizojnë zhvillimin e barabartë. Ky parim kërkon që politikat

vendore të projektohen dhe zbatohen në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, duke u mbështetur në analiza të thelluara të pabarazive ekzistuese.

Një tjetër shtyllë është *trajtimi i diskriminimit të shumëfishtë*, e cila njeh dhe adreson faktin se pabarazitë gjinore shpesh ndërthuren me barriera të tjera si mosha, aftësia e kufizuar, etnia, statusi socio-ekonomik apo orientimi seksual. Kjo qasje garanton që politikat të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura për grupet që përballen me forma të ndërlidhura të përjashtimit shoqëror.

Pjesëmarrja e balancuar në vendimmarrje është një tjetër element kyç, duke synuar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha strukturat e qeverisjes vendore, në organet përfaqësuese dhe ekzekutive, si dhe në proceset e konsultimit publik. Kjo përmirëson cilësinë e vendimeve, rrit legjitimitetin e tyre dhe siguron që perspektiva e të dy gjinive të jetë e pranishme në çdo fazë të vendimmarrjes.

Po aq i rëndësishëm është *eliminimi i stereotipeve gjinore*, i cili kërkon ndryshime kulturore dhe shoqërore që sfidojnë rolet tradicionale dhe kufizuese, duke nxitur një kulturë të re që vlerëson diversitetin, respektin dhe barazinë.

Integrimi i perspektivës gjinore në politikat vendore është një proces transversal që garanton që çdo politikë, program, buxhet dhe shërbim të analizohet dhe të projektohet për të adresuar në mënyrë të barabartë nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave, duke kontribuar në reduktimin e pabarazive dhe promovimin e drejtësisë sociale.

Së fundmi, *planet e veprimit të mbështetura me burime* sigurojnë që angazhimet e këtij plani të përkthehen në rezultate konkrete. Kjo nënkupton sigurimin e burimeve financiare, njerëzore dhe teknike të mjaftueshme, si dhe ndërtimin e mekanizmave të qartë për monitorim, raportim dhe vlerësim, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie në çdo hap të zbatimit.

FUSHAT E NDËRHRYJES

Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 i Bashkisë Sarandë përcakton drejtimet kryesore të punës për arritjen e vizionit dhe objektivave strategjike, duke u mbështetur në një analizë të thelluar të situatës aktuale, trendeve demografike e socio-ekonomike, si dhe në vlerësimin e sfidave dhe

mundësive zhvillimore të territorit. Këto fusha ndërhyrjeje janë të harmonizuara me prioritetet kombëtare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, si dhe me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Çdo fushë ndërhyrjeje synon të adresojë dimensionet të ndryshme të pabarazisë gjinore – nga pjesëmarrja në vendimmarrje dhe fuqizimi ekonomik, te mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore dhe garantimi i aksesit të barabartë në shërbime. Nëpërmjet këtyre fushave, plani synon jo vetëm të eliminojë pengesat ekzistuese, por edhe të krijojë mekanizma të qëndrueshëm që promovojnë përfshirjen, fuqizimin dhe zhvillimin e barabartë të të gjitha grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në territorin e Bashkisë Sarandë.

1. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje

Kjo fushë ndërhyrjeje synon të forcojë demokracinë vendore duke garantuar përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, nga Këshilli Bashkiak deri te strukturat e këshillimit komunitar. Veprimet do të përfshijnë zbatimin e kuotave gjinore, krijimin e programeve për zhvillimin e lidershit të grave dhe vajzave, dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të tyre në proceset e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultimet publike.

2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

Duke u bazuar në potencialet ekonomike të Bashkisë Sarandë, kjo fushë fokusohet në mbështetjen e grave dhe vajzave për të hyrë, qëndruar dhe avancuar në tregun e punës. Ajo përfshin mbështetje financiare dhe teknike për sipërmarrjet femërore, zhvillimin e aftësive profesionale përmes trajnimeve dhe mentorimit, si dhe lehtësimin e aksesit në kredi me kushte të favorshme dhe programe subvencioni. Sektorë prioritarë do të jenë turizmi, agrobiznesi dhe artizanati lokal, duke synuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

3. Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj dhunës me bazë gjinore

Kjo fushë ka në qendër forcimin e mekanizmave të koordinuar për menaxhimin e rasteve të dhunës, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR), si dhe sigurimin e shërbimeve të specializuara për viktimat. Veprimet do të përfshijnë strehim emergjent, ndihmë psikologjike dhe juridike, si dhe fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi për parandalimin e dhunës dhe promovimin e të drejtave të grave. Fokus i veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së grave dhe vajzave në zonat rurale dhe të izoluara.

4. Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore

Objektivi i kësaj fushe është të sigurojë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, të përshtatura me nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në të gjithë territorin e bashkisë. Do të punohet për zgjerimin e mbulimit gjeografik të shërbimeve sociale, ofrimin e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit për të lehtësuar barrën e kujdesit mbi gratë, si dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore cilësore, përfshirë shëndetin riprodhues.

5. Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe buxhetimin vendor

Kjo fushë synon të institucionalizojë integrimin e barazisë gjinore në të gjitha proceset e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave vendore. Veprimet përfshijnë futjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, trajnimin e stafit të administratës mbi analizën dhe raportimin gjinor, si dhe krijimin e mekanizmave për monitorimin e treguesve gjinorë në nivel bashkiak.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Objektivat strategjikë të Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 të Bashkisë Sarandë janë hartuar duke marrë në konsideratë analizën e situatës aktuale, nevojat e identifikuara në komunitet dhe prioritetet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore. Ata synojnë të krijojnë një kornizë të qartë veprimi, me rezultate të matshme dhe të zbatueshme, që garantojnë përfshirjen, mbrojtjen dhe fuqizimin e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në të gjitha fushat e jetës publike dhe private.

Objektivi Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje

Ky objektiv synon të forcojë demokracinë vendore dhe proceset e qeverisjes përmes garantimit të përfaqësimit të balancuar gjinor në organet përfaqësuese dhe ekzekutive. Përfshin:

- Sigurimin e zbatimit të kuotave gjinore në Këshillin Bashkiak dhe në strukturat e administratës vendore.
- Rritjen e numrit të grave në pozita drejtuese dhe në bordet e institucioneve publike lokale, duke krijuar rrugë të qarta avancimi në karrierë.
- Nxitjen e pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në forumet e konsultimit publik, këshillat komunitare dhe proceset e buxhetimit me pjesëmarrje.

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

Fokusi i këtij objektivi është krijimi i mundësive të barabarta ekonomike dhe zhvillimi i potencialit të grave dhe vajzave për të kontribuar dhe përfituar nga rritja ekonomike e territorit. Përfshin:

- Mbështetje financiare dhe teknike për sipërmarrjet e drejtuara nga gra, me prioritet në sektorët e turizmit, agrobiznesit dhe artizanatit lokal.
- Trajnime dhe mentorim për zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë sezonale të zonës.
- Lehtësimin e aksesit në fonde, kredi të buta dhe programe subvencioni për nxitjen e ndërmarrjeve femërore.

Objektivi Strategjik 3: Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj dhunës me bazë gjinore

Ky objektiv synon të garantojë mbrojtjen dhe mbështetjen e plotë për viktimat e dhunës me bazë gjinore, si dhe forcimin e mekanizmave parandalues dhe reagues. Përfshin:

- Forcimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) për menaxhimin e rasteve të dhunës, përmes trajnimeve, protokolleve të unifikuara dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.
- Sigurimin e shërbimeve të specializuara, duke përfshirë strehimin emergjent, mbështetjen psikologjike dhe ndihmën juridike falas për viktimat.

- Organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik për të drejtat e grave, raportimin e rasteve të dhunës dhe promovimin e një kulture tolerancë-zero ndaj dhunës.

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore

Qëllimi i këtij objektivi është sigurimi i shërbimeve cilësore, të qasshme dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për të gjithë qytetarët e Bashkisë Sarandë, pa dallim vendbanimi apo statusi socio-ekonomik. Përfshin:

- Zgjerimin e gamës dhe mbulimit gjeografik të shërbimeve sociale, me fokus në zonat rurale dhe të izoluara.
- Zhvillimin e programeve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, për të lehtësuar barrën e kujdesit mbi gratë dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.
- Sigurimin e shërbimeve shëndetësore të cilësisë së lartë, përfshirë kujdesin shëndetësor riprodhues dhe edukimin shëndetësor të ndjeshëm ndaj gjinisë.

Objektivi Strategjik 5: Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe buxhetimin vendor

Ky objektivi synon të institucionalizojë qasjen e integrimit të perspektivës gjinore në të gjitha proceset e qeverisjes vendore, duke e bërë atë një standard të praktikës administrative. Përfshin:

- Futjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha programet dhe projektet bashkiake.
- Trajnimin e stafit të administratës vendore mbi analizën, planifikimin dhe raportimin me ndjeshmëri gjinore.
- Krijimin e një sistemi të rregullt monitorimi dhe raportimi të treguesve gjinorë, për të ndjekur progresin dhe për të informuar vendimmarrjen.

V. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Zbatimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 në Bashkinë Sarandë mbështetet në një sistem të qartë raportimi dhe monitorimi, i cili garanton transparencë, përfshirje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Për këtë qëllim, pas miratimit të planit, Bashkia do të krijojë Komisionin për Barazi Gjinore / Grupin Monitorues, një strukturë ndërsektoriale me përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative. Ky komision do të ketë rolin e koordinimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit, si dhe të hartimit të raporteve përkatëse për Këshillin Bashkiak.

Çdo drejtori përgjegjëse do të mbledhë të dhëna të rregullta mbi aktivitetet që ka në ngarkim dhe do të raportojë tek Komisioni. Për këtë qëllim, do të hartohen formate standarde dhe tregues të matshëm, të cilët do të mbledhin informacion të disagreguar sipas gjinisë, moshës, vendbanimit dhe statusit social. Monitorimi nuk do të kufizohet vetëm në tregues sasiore (si numri i grave të punësuar, përqindja e grave në vendimmarrje, apo numri i shërbimeve të ofruara), por do të përfshijë edhe tregues cilësorë, për të vlerësuar përvojën e përfituesve dhe ndikimin real të masave në jetën e komunitetit.

Raportimet mbi aktivitetet do të dorëzohen çdo tre muaj, ndërsa një raport gjashtëmuajor mbi objektivat specifike do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak dhe Aleancës së Grave Këshilltare. Përveç kësaj, një raport vjetor i integruar do të bëhet publik përmes faqes zyrtare të bashkisë dhe aktiviteteve konsultative me komunitetin, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve.

Në vitin e tretë të zbatimit të planit parashikohet edhe një vlerësim i ndërmjetëm, i cili do të analizojë progresin dhe do të propozojë ndryshime apo përshtatje në rast se objektivat nuk po arrihen sipas parashikimeve. Ky mekanizëm do të ndihmojë që plani të mbetet dinamik dhe të përshtatet me nevojat reale të qytetarëve dhe zhvillimet e reja sociale.

Raportet e përgatitura do t'i përcillen gjithashtu Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, si dhe partnerëve të tjerë sipas kërkesës. Përveç institucioneve publike, në procesin e monitorimit do të përfshihen edhe organizatat lokale

të shoqërisë civile, të cilat do të kontribuojnë me raporte alternative dhe vlerësime të pavarura, duke rritur kështu besueshmërinë e procesit.

Në bazë të gjetjeve të monitorimit dhe rekomandimeve të palëve të interesit, Plan i do të rishikohet çdo vit, duke u përshtatur me nevojat në zhvillim të komunitetit. Kjo qasje fleksibël siguron që dokumenti të mos mbetet statik, por të funksionojë si një instrument i gjallë, i aftë të udhëheqë politikatat vendore drejt një Sarandë më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Tabela 1. Korniza e monitorimit të PVVBGJ 2025–2030, Bashkia Sarandë

Objektivi Strategjik	Treguesit Kryesorë	Burimi i të dhënave	Frekuenca e raportimit	Struktura përgjegjëse
Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje	- % e grave në Këshillin Bashkiak -Nr. i grave në poste drejtuese - Nr. i forumeve/këshillave me pjesëmarrje të balancuar gjinore	Procesverbalet e Këshillit Bashkiak. Raportet e Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njerëzore. Dokumente konsultimi publik.	Tremujor & Vjetor	Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore. Komisioni për barazinë gjinore dhe çështjet sociale.
Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave	- Nr. i grave të punësuar pas ndërhyrjes - Nr. i bizneseve të reja të drejtuara nga gra	Raportet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik. Agjencia Kombëtare e	Tremujor & Gjashtëmujor	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, AKPA.

	- % e grave të trajnuara që hyjnë në tregun e punës	Punësimit dhe Aftësive. OSHC partnere.		
Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj dhunës me bazë gjinore	- Nr. i rasteve të referuara në MKR - % e viktimave që marrin shërbime të plota - Nr. i fushatave ndërgjegjësuere të realizuara	Raportet e MKR, Drejtoria e Kujdesit Social. Të dhënat e Policisë dhe OSHC-ve.	Gjashtëmuajor & Vjetor	Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje. Drejtoria e Kujdesit Social.
Përmirësimi i aksesit në shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore	- Nr. i qendrave të reja të kujdesit të hapura. - % e grave dhe burrave që përdorin shërbime. - Nr. i programeve arsimore kundër stereotipeve gjinore.	Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë. Drejtorisë së Arsimit dhe Administrimit Financiar. OSHC partnere.	Tremujor & Vjetor	Drejtoria e Kujdesit Social. Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar.
Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe	- Nr. i programeve me buxhetim gjinor.	Raportet financiare të Bashkisë.	Gjashtëmuajor & Vjetor	Drejtoria e Financës. Nëpunësi për Barazinë Gjinore/Koordinatori

buxhetimin vendor	- % e stafit të trajnuar në raportim gjinor. - Nr. i raporteve periodike të përgatitura.	Dokumentet e trajnimeve. Raportet e Komisionit të BGJ.		kundër dhunës në familje.
----------------------	---	--	--	------------------------------

VI. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030

Matrica përbën shtyllën operationale të Planit Vendor për Barazinë Gjinore, duke përkthyer vizionin dhe objektivat strategjikë në masa konkrete që do të zbatohen gjatë periudhës 2025–2030. Ajo paraqet në mënyrë të qartë dhe të strukturuar lidhjen midis objektivave, aktiviteteve, rezultateve të pritura dhe treguesve të matjes, duke i bërë më të dukshme përgjegjësitë institucionale, afatet kohore dhe burimet e nevojshme.

Nëpërmjet kësaj matrice, çdo drejtori e Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, shoqërinë civile dhe partnerët e tjerë, ka mundësinë të ndjekë hap pas hapi progresin e bërë, të evidentojë sfidat dhe të ndërmarrë masa korrigjuese aty ku është e nevojshme. Struktura e saj siguron jo vetëm menaxhim më efikas të aktiviteteve, por edhe një bazë solide për procesin e monitorimit dhe raportimit periodik.

Matrica reflekton gjithashtu parimin e integritetit të perspektivës gjinore në të gjitha fushat e politikave vendore, duke siguruar që masat e planifikuara të adresojnë nevojat specifike të grave dhe burrave në komunitet, veçanërisht ato të grupeve më të cënueshme. Përmes treguesve të matshëm, ajo garanton që rezultatet të mos mbeten në nivel deklarativ, por të përkthehen në ndryshime të prekshme për qytetarët.

Në këtë kuptim, matrica është jo vetëm një mjet teknik i planifikimit, por edhe një instrument i qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies, që e ndihmon Bashkinë Sarandë të avancojë drejt barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivi Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje

Objektivi Strategjik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit e Matjes	Institucionet Përgjegjëse/Partnere	Afati	Burimet e Përafërta
Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje	1. Hartimi dhe zbatimi i masave për respektimin e kuotave gjinore në Këshillin Bashkiak dhe strukturat e administratës vendore. 2. Organizimi i trajnimeve dhe mentorimit për gratë e reja kandidate në zgjedhjet vendore. 3. Nxitja e pjesëmarrjes së grave/vajzave në forume konsultative dhe këshilla komunitare. 4. Fushata informuese mbi të drejtat për pjesëmarrje në vendimmarrje.	Kuota gjinore të respektuara në zgjedhje dhe emërime; rritje e numrit të grave në pozita drejtuese dhe forume publike.	% e grave në Këshillin Bashkiak; nr. grave në poste drejtuese; nr. forumeve me pjesëmarrje të balancuar gjinore.	Bashkia Sarandë. Këshilli Bashkiak. Komisioni për barazinë gjinore dhe çështjet sociale. OSHC locale.	2025–2030	Buxhet bashkiak, donatorë

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

Objektivi Strategjik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit e Matjes	Institucionet Përgjegjëse/Partnere	Afati	Burimet e Përafërta
Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave	1. Mbështetje me grante të vogla për bizneset e drejtuara nga gra në turizëm, agrobiznes, artizanat. 2. Organizim i trajnimeve profesionale të lidhura me sezonin turistik dhe tregun lokal të punës. 3. Krijim i një programi mentorimi për sipërmarrëset e reja.	Gratë dhe vajzat të pajisura me aftësi profesionale dhe burime financiare për zhvillimin e biznesit.	Nr. përfituesve; nr. bizneseve të reja nga gratë; % e grave të punësuaras pas ndërhijjes.	Bashkia Sarandë. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Banka lokale, OSHC	2025–2030	Buxhet bashkiak, programe qeveritare, donatorë

	4. Lehtësim i aksesit në kredi me interes të ulët dhe subvencione për gratë.					
--	--	--	--	--	--	--

Objektivi Strategjik 3: Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj dhunës me bazë gjinore

Objektivi Strategjik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit e Matjes	Institucionet Përgjegjëse/Partnere	Afati	Burimet e Përafërta
Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj DHBGJ	1. Forcimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe trajnime për anëtarët. 2. Sigurimi i shërbimeve të specializuara: strehim emergjent, ndihmë juridike, mbështetje psikologjike.	MKR funksional, rritje e rasteve të referuara dhe trajtuara me sukses, ndërgjegjësim më i madh publik.	Nr. rasteve të trajtuara; % viktimave që marrin shërbime; nr. fushatave dhe përfshirja e komunitetit.	Bashkia Sarandë. Policia. Drejtoria e Kujdesit Social. OSHC. Shkollat.	2025–2030	Buxhet bashkiak, fonde shtetërore, donatorë

	3. Fushata ndërgjegjësimi në qytet dhe fshatra mbi të drejtat dhe raportimin e rasteve të dhunës. 4. Programe edukimi në shkolla për parandalimin e stereotipeve gjinore.					
--	---	--	--	--	--	--

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore

Objektivi Strategjik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit e Matjes	Institucionet Përgjegjëse/Partnere	Afati	Burimet e Përafërta
Përmirësimi i aksesit në shërbime	1. Zgjerim i shërbimeve sociale dhe qendrave ditore në zonat rurale.	Shërbime më të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha grupet gjinore dhe moshore.	Nr. qendrave të hapura. % grave dhe burrave që	Bashkia Sarandë. Drejtoria e Kujdesit Social.	2025–2030	Buxhet bashkiak. programe kombëtare. Donatorë.

	2. Hapje e qendrave të kujdesit për fëmijët dhe programe për të moshuarit. 3. Sigurimi i shërbimeve shëndetësore të ndjeshme ndaj gjinisë, përfshirë shëndetin riprodhues. 4. Programe arsimore kundër diskriminimit dhe stereotipeve.		përdorin shërbimet. nr. programeve arsimore.	Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar. OSHC.		
--	---	--	--	--	--	--

Objektivi Strategjik 5: Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe buxhetimin vendor

Objektivi Strategjik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit e Matjes	Institucionet Përgjegjëse/Partnere	Afati	Burimet e Përafërta
Integrimi i perspektivës gjinore	1. Futja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha programet dhe projektet. 2. Trajnime për stafin e administratës vendore mbi integrimin e barazisë gjinore në planifikim dhe raportim. 3. Monitorimi dhe raportimi periodik i treguesve gjinorë. 4. Hartimi i udhëzuesve për integrimin e perspektivës gjinore në çdo sektor.	Politika dhe buxhete të ndjeshme ndaj gjinisë; Transparencë më e madhe mbi barazinë gjinore.	Nr. programeve me buxhetim gjinor. % stafit të trajnuar. nr. raporteve periodike.	Bashkia Sarandë. Drejtoria e Financës. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. OSHC.	2025–2030	Buxhet bashkiak, donatorë

Elementët plotësues dhe aspektet mbështetëse të planit

Matricës së Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2030 i janë shtuar disa elementë plotësues që garantojnë koherencë, realizueshmëri dhe mundësi të qarta për monitorim e vlerësim të ndërhyrjeve. Këta elementë janë integruar për të siguruar koherencë të brendshme të planit, për ta bërë atë të zbatueshëm në praktikë dhe për të lehtësuar ndjekjen e rezultateve e ndikimeve në një perspektivë afatgjatë.

Rrisqet dhe masat parandaluese

Zbatimi i planit mund të përballë me rrisqe të ndryshme, si kufizime financiare, mungesë burimesh njerëzore të specializuara, vështirësi në koordinimin ndërinstitutional, apo ndikimin e vazhdueshëm të stereotipeve gjinore në komunitet. Për t'i adresuar, parashikohen masa parandaluese që përfshijnë sigurimin e burimeve shtesë financiare përmes partneriteteve me donatorë dhe sektorin privat, forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, si dhe zhvillimin e fushatave të qëndrueshme të ndërgjegjësimit publik.

Rezultatet afatgjata

Plani nuk kufizohet vetëm në objektiva afatshkurtra, por synon të gjenerojë ndikime të qëndrueshme në afatgjatë. Ndryshimet e pritshme përfshijnë: rritjen e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje, fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, përmirësimin e aksesit në shërbime sociale dhe shëndetësore cilësore, si dhe reduktimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Këto do të maten përmes treguesve sasiorë dhe cilësorë që pasqyrojnë transformime strukturore dhe shoqërore në nivel vendor.

Grupet prioritare

Një parim themelor i planit është gjithëpërfshirja. Për këtë arsye, ai fokusohet në mbështetjen e grupeve më të cenueshme të komunitetit: gratë kryefamiljare, vajzat dhe gratë në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe të moshuarit. Përfshirja e këtyre grupeve siguron që masat e planifikuara të jenë të drejta dhe të adresojnë realisht nevojat më emergjente.

Mekanizmat e monitorimit

Zbatimi i planit do të ndiqet nëpërmjet një sistemi të qartë monitorimi, që përfshin raporte periodike tremujore dhe gjashtëmujore, mbledhje të rregullta të Komisionit për Barazinë Gjinore, vizita në terren dhe konsultime me komunitetin. Këto mekanizma mundësojnë ndjekjen e progresit, identifikimin e hershëm të sfidave dhe përshtatjen fleksibile të masave kur kërkohet.

Lidhja me kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare

Plani është ndërtuar në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe politikat sektoriale përkatëse. Njëkohësisht, ai kontribuon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht SDG 5 (Barazia gjinore), SDG 8 (Punësimi dhe rritja ekonomike) dhe SDG 16 (Institucione gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse). Ky harmonizim i jep planit një dimension më të gjerë, duke e pozicionuar si pjesë të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Mekanizmat e llogaridhënies dhe transparencës

Progresi i planit do të bëhet i aksesueshëm për publikun përmes raporteve vjetore të publikuara nga Bashkia Sarandë, tryezave konsultuese me komunitetin dhe publikimeve në faqen zyrtare të bashkisë. Ky dimension i transparencës siguron që qytetarët të jenë të informuar mbi arritjet, sfidat dhe masat korrigjuese të ndërmarra, duke rritur besimin dhe përgjegjshmërinë institucionale.

Dimensioni gjinor i krizave dhe emergjencave

Saranda, si një bashki bregdetare me prurje të larta turistike dhe me sfida të mundshme nga fatkeqësitë natyrore apo emergjencat shëndetësore, duhet të integrojë perspektivën gjinore në menaxhimin e krizave. Kjo do të thotë që në rast evakuimi, humbjeje të vendeve të punës sezonale apo përballjes me situata emergjente, gratë dhe burrat të kenë akses të barabartë në ndihmë, mbështetje dhe informim.

Pjesëmarrja e komunitetit dhe grupeve të interesit

Përveç institucioneve vendore, plani do të mbështetet në një proces të vazhdueshëm konsultimi me komunitetin, përfshirë gratë, burrat, të rinjtë, organizatat lokale dhe grupet e cënueshme. Ky dimension siguron që masat të jenë të rrënjësura në realitetin e komunitetit dhe të adresojnë nevojat e tij konkrete.

Treguesit cilësorë dhe kulturorë

Përveç treguesve sasiorë si përqindja e grave në vendimmarrje apo numri i bizneseve të drejtuara nga gra, vlerësimi i planit do të përfshijë edhe tregues cilësorë. Këto lidhen me ndryshimin e perceptimeve në komunitet, reduktimin e stereotipeve gjinore, rritjen e vetëbesimit të grave dhe fuqizimin e rolit të tyre në jetën publike dhe familjare.

Qëndrueshmëria pas vitit 2030

Një element thelbësor i planit është garantimi i vazhdimësisë përtej periudhës 2025–2030. Praktikrat e reja, si buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, do të institucionalizohen si pjesë e procedurave standarde të bashkisë. Në këtë mënyrë, rezultatet e arritura nuk do të varen vetëm nga fondet afatshkurtra, por do të shndërrohen në mekanizma të qëndrueshëm të administratës vendore.

VII. KOSTIMI DHE BURIMET FINANCIARE

Zbatimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 kërkon mbështetje të qëndrueshme si në burime financiare, ashtu edhe në kapacitete njerëzore. Bashkia Sarandë ka tashmë një praktikë të konsoliduar për ndarjen e fondeve të dedikuara për barazinë gjinore, parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e rasteve sociale me problematika të ndryshme. Aktualisht, ky angazhim financohet përmes programit buxhetor nr. 1110 “Shërbimet Sociale”, i cili përfshin edhe masat dhe aktivitetet e lidhura me barazinë gjinore dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës. Kjo strukturë buxhetore ofron një bazë të fortë për të garantuar vazhdimësinë dhe forcimin e politikave të ndjeshme gjinore në nivel vendor.

Në periudhën 2021–2024, Bashkia Sarandë ka vendosur në dispozicion fonde të dedikuara në rritje graduale, duke reflektuar përkushtimin institucional për këtë fushë. Konkretnisht, në vitin 2021 është buxhetuar shuma prej **159,800 lekësh**, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 kjo shumë është rritur në **300,000 lekë** çdo vit. Në vitin 2024, fondi i ndarë për barazinë gjinore, dhunën në familje dhe rastet sociale me problematika të ndryshme ka arritur në **500,000 lekë**.

Duke u mbështetur mbi këtë praktikë pozitive, për periudhën 2025–2030 parashikohet një rritje e mëtejshme graduale e fondeve, me synim forcimin e kapaciteteve vendore për të përmbushur objektivat e këtij plani dhe për të integruar buxhetimin gjinor në të gjitha programet e bashkisë. Ky projeksion orientues synon të garantojë jo vetëm financimin e aktiviteteve të planifikuara, por edhe sigurimin e qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve në afatgjatë.

Tabela 2. Buxhetimi ekzistues (2021–2024)

Viti	Shuma e ndarë (lekë)	Destinacionet kryesore
2021	159,800	Barazia gjinore, dhuna në familje, mbështetje sociale
2022	300,000	Barazia gjinore, dhuna në familje, mbështetje sociale
2023	300,000	Barazia gjinore, dhuna në familje, mbështetje sociale
2024	500,000	Barazia gjinore, dhuna në familje, mbështetje sociale

Tabela 3. Projektioni i buxhetimit për periudhën 2025–2030

Viti	Shuma e parashikuar (lekë)	Aktivitetet kryesore për çdo vit
2025	600,000	Zbatimi i aktiviteteve të PVVBGJ; shërbime për viktimat e dhunës
2026	700,000	Programe për fuqizimin ekonomik të grave dhe parandalimin e dhunës
2027	800,000	Trajnime, fushata ndërgjegjësimi, shërbime sociale gjithëpërfshirëse
2028	800,000	Mbështetje për Mekanizmin e Referimit dhe shërbime të specializuara
2029	800,000	Zgjerim i investimeve në shërbime gjithëpërfshirëse për barazinë gjinore
2030	800,000	Qëndrueshmëri financiare dhe integrim i plotë i buxhetimit gjinor në të gjitha sektorët

Ky plan financiar parashikon një rritje graduale të buxhetimit gjatë viteve 2025–2027, ndërsa për periudhën 2028–2030 fondet mbeten në një nivel të qëndrueshëm. Kjo qasje tregon angazhimin e Bashkisë Sarandë për të garantuar një financim të mjaftueshëm dhe të vazhdueshëm për zbatimin e objektivave strategjikë të Planit Vendor për Barazinë Gjinore.

Përveç alokimeve nga buxheti vendor, zbatimi i planit do të mbështetet në mobilizimin e fondeve shtesë nga qeveria qendrore, donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky partneritet financiar do të kontribuojë jo vetëm në mbulimin e hendekëve buxhetorë, por edhe në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira që rrisin cilësinë e ndërhyrjeve.

Në këtë kuadër, Bashkia Sarandë synon të ndërtojë një model të qëndrueshëm bashkëpunimi trepalësh: *bashki–donatorë–qeveri qendrore*, i cili garanton integrimin e perspektivës gjinore në çdo nivel politikash dhe programesh. Kjo strukturë buxhetore kombinon rritjen fillestare me konsolidimin afatgjatë, duke siguruar që masat e parashikuara të mbështeten me burime të qëndrueshme dhe me ndikim afatgjatë.